



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

02 Nr. 149 -25
Me 28/08-2025
Mamushë



Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008), Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës, lidhur me nenin 19 pika 19.16 të Rregullores nr.002/2024 Për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores nr. 001/2022 për prokurimin publik, lidhur me nenin 44 dhe 46 Ligji nr. 05/1 -031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushës të datës 01.12.2008, Kryetari i Komunës së Mamushës merr këtë:

V E N D I M

Për emërimin e personit përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencës për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Gjenerator dhe pajisje elektrike për pastrimin e dysHEMEVE - për objektet komunale" Komuna e Mamushës

NENI 1

Z. Yahya Šala Drejtor i Administratës së Përgjithshme **Caktohet** personi përgjegjës nga njësia Kërkuese për hartimin e specifikimeve teknike/ termat e referencës për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Gjenerator dhe pajisje elektrike për pastrimin e dysHEMEVE - për objektet komunale" Komuna e Mamushës"

NENI 2

Personi përgjegjës sipas nenit 1 të këtij vendimi, ka për detyrë që të bëjë hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencës, duke u bazuar në Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, lidhur me nenin 19 pika 19.16 të Rregullores nr.002/2024 Për Plotësimin Dhe Ndryshimin e Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin.

NENI 3

Obligohet- zyrtari përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike/ termat e referencës që në bazë të nenit 28 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, lidhur me nenin 19 pika 19.16 të Rregullores nr.002/2024 Për Plotësimin Dhe Ndryshimin e Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin.

3.1. Deklaratë me të cilën deklaron se specifikimet teknike/ termat e referencës janë në përputhje me qëllimin e aktivitetit të prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik, që specifikimet teknike/ termat e referencës janë përgatitur në atë mënyrë që nuk favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.

3.2. që Specifikimet teknike nuk i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, ose një procesi të hollësishëm, ose ndonjë shenje dalluese, lloji ose origjine të veçantë ose ndonjë prodhimi.

3.3 Obligohet personi përgjegjës që se bashku me Specifikimet teknike/ termat e referencës të plotësoj dhe të dorëzojë Deklaratën nën Betim, duke përdorur formularin standard të aprovuar nga KRPP.

NENI 4

Personi përgjegjës obligohet që ta dorëzojë specifikat teknike të hartuara tek Njësia Kërkuese me qëllim të Inicimit të Procedurës së Prokurimit.

NENI 5

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

ARSYETIM

Në bazë të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, si dhe në përputhje me nenin 19 pika 19.16 të Rregullores Nr. 002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin, Njësia Kërkuese ka për obligim të caktojë një person përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike apo termave të referencës për çdo aktivitet prokurimi.

Specifikimet teknike dhe termat e referencës janë dokumente kyçe për zhvillimin e një procedure transparente dhe efikase të prokurimit, të cilat duhet të përpilohen në pajtim të plotë me dispozitat ligjore, duke garantuar konkurrencë të ndershme dhe qasje të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar. Përgatitja e saktë dhe e paanshme e këtyre dokumenteve është thelbësore për të shmangur konfliktet e interesit, si dhe për të siguruar suksesin e aktivitetit të prokurimit në të gjitha fazat e tij.

Në këtë drejtim, për të garantuar përputhshmërinë me kërkesat ligjore dhe për të siguruar cilësi dhe përgjegjësi institucionale në hartimin e dokumentacionit të prokurimit, caktohet personi përgjegjës sipas dispozitave në vijim të këtij vendimi.

Me këtë vendim të njoftohet:

1. I/E caktuari/a
2. Drejtorisë përkatëse.
3. Zyra e Prokurimit dhe
4. Arkiva.

Kryetari i Komunës së Mamushës





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

MAMUŠA BELEDIYESI - KOMUNA E MAMUSHËS - OPŠTINA MAMUŠA - MUNICIPAL OF MAMUŠA

02 Nr. 48/25
Me 27.08.2025

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008 nenit 40, paragrafi 1 dhe 2 pika 2.1, 2.2 dhe 2.3 paragrafi 3 dhe 4 i Ligjit NR.08/L-197 për zyrtar publik (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës NR.21/18 shtator 2023, lidhur me nenin 20, paragrafi 1 dhe 2, pika 2.1, 2.2 dhe 2.3 Rregullore (QRK) NR. 15/2023 Për Procedurën E Pranimiit Në Shërbimin Civil nenit 44, 45 dhe 46 të Ligjit i nr. 05/L-031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

V E N D I M

Për plotësim ndryshimin e vendimit 02.Nr.60/25 të datës 08.04.2025 për formimin e Komisionit të pranimiit për pozitat të kategorisë profesionale

Neni I

Formohet: Komisioni për zhvillimin e procedurave për pranim në shërbim civil në pozitën të kategorisë profesionale në Komunën e Mamushës.

Neni II

Komisioni i Pranimiit në pajtim me neni I të këtij neni përbëhet nga:

1. Znj. Sihana Uka- Kryesuese Menaxhere e personelit
2. znj. Esra Osi - anëtare Shefe e Sektorit DPUGJK
3. Z. Skender Sala- anëtar- Udhëheqës i Sektorit në Administratën e Përgjithshme
4. Z. Çabej Nurkollar- Zyra Ligjore e Komunës së Mamushës
5. Z. Aziz Elshani- Anëtar Zyrtar i Lartë Financiar.

Në përbërje të Komisionit caktohet edhe një **anëtar rezervë**, i cili do të zëvendësojë ndonjë nga anëtarët e rregullt në rast mungese, sipas nevojës:

- Z. Labinot Muhaxheri – Anëtare Rezervë, Inspektor i Tregut.

Neni III

Komisioni i pranimiit si në pikën II ka mandat 2 vjeçar, nga dita e nënshkrimit të këtij vendimit, me mundësi të ripërtëritjes sipas nevojës.

Neni IV

Detyrat, kompetencat dhe përgjegjësitë e komisionit janë të përcaktuara me Ligjit NR.08/L-197 për zyrtar publik dhe Rregullore (QRK) NR. 15/2023 Për Procedurën E Pranimiit Në Shërbimin Civil.

Kryetar i Komunës së Mamushës


Abdullahi KRASNICI





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



ZYRA E KRYETARIT

02. Nr. 147-25

Me datë: 22.08.2025

Komuna e Mamushës

Në bazë të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, lidhur me nenin 18 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.2 të Rregullores (QRK) nr. 19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendës drejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesionalë, Asistentëve, Instruktorëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar, si dhe nenit 82.6 të Statutit të Komunës së Mamushës të datës 01.12.2008, Kryetari i Komunës sjell këtë:

V E N D I M

Për ri-emërimin e përkohshëm si Ushtrues Detyre në Pozitën e Drejtorit të SH.F.M.U “ANADOLU”

Neni I

z. Erol Morina caktohet Ushtrues Detyre Drejtor të Shkollës Filllore të Mesme të Ulët “ANADOLU” në Komunën e Mamushës për një afat prej tre (3) muajsh, duke filluar nga data 19.08.2025 deri më 19.11.2025.

Neni II

Obligohet Zyra e Personelit që brenda afatit ligjor të shpallë konkurs të ri për rekrutimin në pozitën e drejtorit të SH.F.M.U “ANADOLU” në Komunën e Mamushës.

Neni III

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë në ditën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

Ri-emërimi i U.D. Drejtorit është bërë për shkak të përfundimit të kontratës së drejtorit të mëparshëm të shkollës dhe dështimit në konkursin e hapur. Në mungesë të pozitës së Drejtorit të Shkollës Filllore të Mesme të Ulët “ANADOLU”, z. Erol Morinës i vazhdohet vendimi konform kërkesës së DKA-së, duke e caktuar si U.D. Drejtor deri në përfundim të procedurave të përzgjedhjes së Drejtorit me konkurs.

Pas shqyrtimit të kërkesës së Drejtorisë së Arsimit pranë Komunës së Mamushës për ri-emërimin e Drejtorit të Shkollës Filllore, ajo është aprovuar duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.

Vendimi për caktimin e U.D. Drejtorit të Shkollës Filllore të Mesme të Ulët “ANADOLU” pranë Komunës së Mamushës është vazhduar në përputhje me Rregulloren (QRK) nr. 19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendës drejtorëve, Mësimdhënësve,

Bashkëpunëtorëve Profesionalë, Asistentëve, Instruktorëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar.

Emërimi i përkohshëm i drejtorit dhe zëvendësdrejtorit bëhet nga subjektet përgjegjëse për emërimin me mandat të plotë të kandidatëve për këto pozita, kur vendi i punës shpallet i lirë dhe emërimi i përkohshëm vazhdon deri në përfundimin e procedurave ligjore për përzgjedhje, sipas Rregullores.

Duke marrë parasysh fillimin e vitit shkollor, U.D. Drejtori Erol Morina është duke udhëhequr institucionin shkollor dhe është vlerësuar se duhet të vazhdojë të mbajë këtë pozitë deri në përfundim të procedurave, duke siguruar organizimin e nxënësve, mësimeve dhe funksionimin e rregullt të vitit shkollor 2025/2026.

Për të gjitha arsyet e lartcekura, është vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

Njoftohen:

- DKA
- Z. Erol Morina
- Zyra e Personelit
- Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdullah Krasniq





REPUBLIKA E KOSOVËS – KOSOVA CUMHURIYETI
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
MAMUŠA BELEDIYESI – KOMUNA E MAMUSHËS
OPŠTINA MAMUŠA – MUNICIPALITY OF MAMUSA

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti Republika Kosovo-Republic of Kosovo Mamuša Beledijesi-Komuna e Mamushës Opština Mamuša-Municipality of Mamusa	
Çikës - Dalëse - Izlaza - Outgoing	
02	No.Nr. 146-25
Tarih/Datë	22.08.2025



02 Nr. 146 / 25
Më: 22.08.2025
Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, nenit 87.2 të Statutit të Komunës së Mamushës të datës 01.12.2008, në bazë të Ligjit të Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Rregullorës me nr. 002/2024 dhe Udhëzuesit të Prokurimit Publik, Kryetari i Komunës Mamushës mori këtë:

VENDIM

Për emërimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës.

I

Menaxher i kontratës për projektin me titull: "FURNIZIMI ME DRU DHE PELET PËR NGROHJE" me numër të prokurimit: 626-25-5505-1-2-1 dhe me nr. të brendshëm 626-25-006-1-2-1, emërohet z. **Gëlan Kruezi**, ndërsa Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës për projektin në fjalë emërohet z. **Nazmi Morina**.

II

Pas pranimit të kontratës, menaxheri i kontratës do të përgatis një plan për menaxhimin e kontratës duke përdorur funksionin "Fillimi/mobilizimi i kontratës". Plan i menaxhimit të kontratës do të krijohet nga sistemi i prokurimit elektronik dhe duhet të përgatitet për të gjitha kontratat me vlere të madhe, të mesme dhe të vogël. Plan i menaxhimit të kontratës do të përgatitet para fillimit të zbatimit të kontratës dhe me pajtimin e palëve të kontratës. Kjo do të dokumentohet me nënshkrimet e të dy palëve, përkatësisht të ekipi të menaxhimit të kontratës dhe Operatorit Ekonomik, ekipi i menaxhimit të kontratës, do ta ngarkoj një kopje të planit për menaxhimin e kontratës në sistemin elektronik të prokurimit.

III

Përgjegjësitë e Menaxherit të Projektit/Kontratës

Menaxheri i Projektit/Kontratës do të:

a. Menaxhoj obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuara në kontratë;

- b. Sigurojë se Operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara në kontratë; dhe
- c. Bëj vlerësimin e performancës së kontraktuesve për kontratat nën menaxhimin e tij.

Funksionet e Menaxherit të Projektit/kontrates janë:

- a. Të sigurojë që Operatori ekonomik i përmbush të gjitha obligimet e performancës apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- b. Të sigurojë që Operatori ekonomik e dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- c. të sigurojë që Autoriteti Kontraktues i përmbush të gjitha pagesat dhe obligimet tjera në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- d. Të sigurojë se ka kontroll adekuat të kostove, cilësisë, dhe kohës aty ku është e përshtatshme;
- e. Të sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së kontratës;
- f. Të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës në sistemin të prokurimit elektronik;
- g. Të nxjerr variacione apo urdhra për ndryshim nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- h. T'i sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës Departamentit të Prokurimit dhe ta marr miratimin;
- i. Të menaxhojë dorëzimet e procedurave të pranimit të punëve, mallrave dhe shërbimeve
- j. Të jep detaje të plota për ndonjë ndërprerjeje të propozuar të kontratës Departamentit të Prokurimit; dhe
- k. T'i dorëzojë raportet mbi progresin ose kompletimin e një kontrate siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit ose nga ZKA.
- l. Të lëshojë Certifikatat e nënshkruara për dorëzimet (Certifikatën e përkohshme/të përhershme).

V

Përgjegjësitë e mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës:

Mbikqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës është përgjegjës për Shqyrtimin, aprovimin dhe procesimin e vlerësimit të performancës së kontraktuesve të plotësuar në platformën e e-prokurimit nga menaxherët e kontratave nën mbikqyrjen e tij/saj.

VI

Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, duhet t'i përmbahen me përpikëri i Ligjit të Prokurimit Publik (LPP) 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 si dhe rregullave tjera të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e kontratës.

VII

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe vlen deri në ekzekutim të kontratës apo marrjen e një vendimi tjetër me shkrim.

Me këtë vendim të njoftohet:


- *Drejtoria e Administratës,*
- *Drejtoria e Shëndetësisë dhe mirëqenies sociale,*
- *Drejtoria e Arsimit, shkences dhe teknologjis,*
- *Drejtoria e Sërbimeve Publike,*
- *Zyra e Prokurimit,*
- *Pala,*
- *Arkivit.*

Abdullahi Krasniq
Kryetari i Komunës së Mamushës





REPUBLIKA E KOSOVËS – KOSOVA CUMHURIYETI
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
MAMUŠA BELEDIYESI – KOMUNA E MAMUSHËS
OPŠTINA MAMUŠA – MUNICIPALITY OF MAMUSA



02 Nr. 145 / 25
Më: 21.08.2025
Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, nenit 87.2 të Statutit të Komunës së Mamushës të datës 01.12.2008, në bazë të Ligjit të Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Rregullorës me nr. 002/2024 dhe Udhëzuesit të Prokurimit Publik, Kryetari i Komunës Mamushës mori këtë:

VENDIM

Për emërimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës.

I

Menaxher i kontratës për projektin me titull: "FURNIZIMI ME MATERIAL SHPENZUES MEDICINAL PËR LABORATOR TË QKMF-s NË MAMUSHË" me numër të prokurimit: 626-25-4792-1-3-6 dhe me nr. të brendshëm 626-25-005-1-3-6, emërohet z. Caner Morina, ndërsa Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës për projektin në fjalë emërohet z. Burak Morina.

II

Pas pranimit të kontratës, menaxheri i kontratës do të përgatis një plan për menaxhimin e kontratës duke përdorur funksionin "Fillimi/mobilizimi i kontratës". Plan i menaxhimit të kontratës do të krijohet nga sistemi i prokurimit elektronik dhe duhet të përgatitet për të gjitha kontratat me vlerë të madhe, të mesme dhe të vogël. Plan i menaxhimit të kontratës do të përgatitet para fillimit të zbatimit të kontratës dhe me pajtimin e palëve të kontratës. Kjo do të dokumentohet me nënshkrimet e të dy palëve, përkatësisht të ekipi të menaxhimit të kontratës dhe Operatorit Ekonomik, ekipi i menaxhimit të kontratës, do ta ngarkoj një kopje të planit për menaxhimin e kontratës në sistemin elektronik të prokurimit.

III

Përgjegjësitë e Menaxherit të Projektit/Kontratës

Menaxheri i Projektit/Kontratës do të:

a. Menaxhoj obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuara në kontratë;

- b. Sigurojë se Operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara në kontratë; dhe
- c. Bëj vlerësimin e përformancës së kontraktuesve për kontratat nën menaxhimin e tij.

Funksionet e Menaxherit të Projektit/kontrates janë:

- a. Të sigurojë që Operatori ekonomik i përmbush të gjitha obligimet e përformancës apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- b. Të sigurojë që Operatori ekonomik e dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- c. Të sigurojë që Autoriteti Kontraktues i përmbush të gjitha pagesat dhe obligimet tjera në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- d. Të sigurojë se ka kontroll adekuat të kostove, cilësisë, dhe kohës aty ku është e përshtatshme;
- e. Të sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së kontratës;
- f. Të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës në sistemin e prokurimit elektronik;
- g. Të nxjerr variacione apo urdhra për ndryshim nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- h. Të sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës Departamentit të Prokurimit dhe ta marrë miratimin;
- i. Të menaxhojë dorëzimet e procedurave të pranimit të punëve, mallrave dhe shërbimeve
- j. Të jep detaje të plota për ndonjë ndërprerje të propozuar të kontratës Departamentit të Prokurimit; dhe
- k. Të dorëzojë raportet mbi progresin ose kompletimin e një kontrate siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit ose nga ZKA.
- l. Të lëshojë Certifikatat e nënshkruara për dorëzimet (Certifikatën e përkohshme/të përhershme).

V

Përgjegjësitë e mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës:

Mbikqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës është përgjegjës për Shqyrtimin, aprovimin dhe procesimin e vlerësimit të përformancës së kontraktuesve të plotësuar në platformën e e-prokurimit nga menaxherët e kontratave nën mbikqyrjen e tij/saj.

VI

Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, duhet t'i përmbahen me përpikëri i Ligjit të Prokurimit Publik (LPP) 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 si dhe rregullave tjera të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e kontratës.

VII

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe vlen deri në ekzekutim të kontratës apo marrjen e një vendimi tjetër me shkrim.

Me këtë vendim të njoftohet:

- *Drejtoria e Shëndetësisë dhe mirëqenies sociale,*
- *Zyra e Prokurimit,*
- *Pala,*
- *Arkivi.*

Abdullahi Krasniq
Kryetari i Komunës së Mamushës





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

	Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti Republika Kosova-Republic of Kosovo Mamuša Belediyesi-Komuna e Mamushës Opština Mamuša-Municipality of Mamusa	
Çıkış - Dalëse - Izlaza - Outgoing		
02	No.Nr.	144-25
Tarih/Dt.		14.08.2025

02 Nr. 144/25
Me 14.08.2025
Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, Memorandum Bashkëpunimi ndërmjet Komuna e Mamushës dhe OJQ Agjencia për Zhvillim Rajonal Jug 02/Nr.68/24 e datës 02.10.2024, Raportin e Agjencisë për zhvillim Rajonal Jug e datës 08.08.2025 dhe nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushës, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

V E N D I M

Për pagesën Memorandum Bashkëpunimi ndërmjet Komuna e Mamushës dhe OJQ Agjencia për Zhvillim Rajonal Jug

Neni 1

Komuna e Mamushës dhe Agjencia për Zhvillim Rajonal Jug kanë nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi, me qëllim të zbatimit të politikave të zhvillimit rajonal me qëllim të krijimit të vendeve të punës në Komunën e Mamushës dhe rritjen e kapaciteteve njerëzore lokale të Komunës së Mamushës përmes projekteve të financuara nga burimet e brendshme dhe të jashtme.

Neni 2

Bazuar në Memorandumin me nr. të protokollit 02/Nr-68-24 i datës 02.10.2024 përgjegjësitë e Komunës së Mamushës janë ta parapara në këtë Memorandum, gjegjësisht në nenin 3 paragrafi 3.2, ku si obligim e palëve të përcaktuar në këtë nen theksohet se Komuna e Mamushës financo projektin në fjalë.

Neni 3

Mjetet që lejohen në shumën prej 5,712 € sipas Raportin e Agjencisë për Zhvillim Rajonal Jug e datës 08.08.2025, pagesa për periudhën e muajit gusht 2025, sipas numrit të zotimit 2025-154771.

Neni 4

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

Me këtë vendim të njoftohet

1. Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik
2. Palëve
3. Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdullahi Krasniç





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

MAMUŠA BELEDIYESI - KOMUNA E MAMUSHËS - OPŠTINA MAMUŠA - MUNICIPAL OF
MAMUSA

Zyra e Kryetarit

02 Nr. 143/25

Me 08.08.2025

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) nenit 40, paragrafi 1 dhe 2 pika 2.1, 2.2 dhe 2.3 paragrafi 3 dhe 4 i Ligjit NR.08/L-197 për zyrtar publik (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës) NR.21/18 shtator 2023, lidhur me nenin 12, paragrafi 1 dhe 3, pika 3.1, 3.2 dhe 3.3 Rregullore (QRK) NR. 30/2024 Për Procedurën E Pranimi të nëpunësve në Shërbimin Publik nenit 44, 45 dhe 46 të Ligjit i nr. 05/1 -031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

V E N D I M

Komisioni i pranimi për pozitë të kategorisë profesionale për Mjekë të Përgjithshëm

Neni I

Formohet: Komisioni për zhvillimin e procedurave për pranim në shërbim publik në pozitë të kategorisë profesionale në Komunën e Mamushës.

Neni II

Komisioni i Pranimi në pajtim me neni I të këtij neni përbëhet nga:

1. Znj. Sihana Uka- Kryesuese Menaxhere e personelit
2. Z. Ramadan Mazreku - anëtarë Shef i QKMF-së
3. Z. Mirat Morina - anëtar- Udhëheqës i Sektorit në QKMF
4. Z. Jakup Dashi -anëtar-Mjeke e Përgjithshme
5. Z. Beqir Kokollari – anëtar- Mjek i Përgjithshëm

Neni III

Komisioni i pranimi si në pikën II ka mandat 2 vjeçar, nga dita e nënshkrimit të këtij vendimit, me mundësi të ripërtëritjes sipas nevojës.

Neni IV

Detyrat, kompetencat dhe përgjegjësitë e komisionit janë të përcaktuara me Ligjit NR.08/L-197 për zyrtar publik dhe Rregullore (QRK) NR. 30/2024 Për Procedurën e Pranimi të nëpunësve në Shërbimin Publik

Neni V

Me këtë vendim shfuqizohet Vendimi me numër të protokolit 02/Nr.08-25 të datës 20.01.2025

ARSYETIM

Ndryshohet përbërja e Komisionit për zhvillimin e procedurave për pranim për Shërbimin Publik në pozitën e kategorisë profesionale në Komunën e Mamushës me këtë vendim ndryshohet neni II pika 4. ku sipas vendimit 02/Nr.08-25 të datës 20.01.2025 në pozitën anëtare e Komisionit ka qenë znj.Xhenana Hyeni e cila ka qenë e caktuar poashtu si anëtare e Komisionit, andaj në bazë të vendimit me nr. Protokoli 02/141-25 të datës 08.08.2025 AKTVENDIM mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës me dorëheqje të nëpunësit publik, znj.Xhenanan Hyseni largohet nga pozita e anëtares së Komisionit, me këtë vendim emërohet z.Jakup Dashi për zhvillimin e procedurave për pranimin në shërbimin Publik.


Kryetar i Komunës së Mamushës
Abdülhadi KRASNIC





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

	Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti Republika Kosova-Republic of Kosovo Mamuşa Belediyesi-Komuna e Mamushës Opština Mamuša-Municipality of Mamusa	
Çikës - Dalëse - Izlazna - Outgoing		
02	No.Nr.	142-25
Tarih/Dt.		08.08.2025

ZYRA E KRYETARIT

02 Nr. 142/25

Me 08.08.2025

Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, lidhur me Ligji nr. 08/L-196 Për Pagat në Sektorin Publik, lidhur me nenin 68 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës lidhur me nenet 74 paragrafi 1 pika 1.7, neni 75 dhe 87 paragrafi 1 i Ligjit për Zyrtarët Publikë, Nr.08/L-197, si dhe nenit 82 të Statutit të komunës së Mamushës dhe lidhur me vendimin 02.Nr.141/5 të datës 08.08.2025, kryetari i Komunës, merr:

V E N D I M

Për largimin nga Lista e Pagave

Neni 1

Në bazë të vendimit nr. 02.Nr.141/25, të datës 08.08.2025, për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me dorëheqje, të znj. Xhenana Hyseni, me numër personal [REDACTED] largohet nga lista e pagave nga data 08.08.2025, në kuadër të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare – Mamushë, nën përgjegjësinë e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 2

Obligohet Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale që, pas nënshkrimit të këtij vendimi, të ndërmarrë veprimet e nevojshme për largimin e znj. Xhenana Hyseni nga lista e pagave dhe përditësimin e të dhënave në sistemin administrativ përkatës.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi më datë 08.08.2025 dhe nga ai moment krijon pasoja juridike për palët e përfshira, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

A R S Y E T I M

znj. Xhenana Hyseni, e sistemuar në pozitën Mjeke e Përgjithshëm pranë Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Komunën e Mamushës, ka paraqitur dorëheqjen e saj me vullnet të lirë, e cila është pranuar me vendimin nr. 02.Nr.141/25, të datës 08.08.2025. Në përputhje me këtë vendim, marrëdhënia e saj e punës është ndërprerë me datën 08.08.2025.

Bazuar në Ligjin Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, si dhe në rregulloret përkatëse për administrimin e listës së pagave, znj. Xhenana Hyseni duhet të largohet nga lista e pagës, duke reflektuar gjendjen reale të marrëdhënies së saj të punës.

Ky veprim synon të sigurojë përputhshmëri me kornizën ligjore dhe menaxhim të drejtë të burimeve financiare të Komunës.

Njoftohen

1. DSHMS.
2. Thesari
3. ARKIVI

Kryetari i Komunës së Mamushës



Abdullah Krasniqi



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

02- Nr. 141-25

Me datë 08.08.2025

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), nenit 68 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, në lidhje me nenet 72, 73, 74 paragrafi 1 pika 1.7, neni 75 lidhur me nenin 87 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrat e Publikë, lidhur me deklaratën e dërguar përmes emailit për dorëheqje nga marrëdhënia e punës me nr. protokoli 08.Nr-17-25 të datës 08.08.2025 si dhe nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushës, Kryetari i Komunës nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

Mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës me dorëheqje të nëpunësit publik

Neni I

znj. Xhenana Hyseni, me numër personal [REDAKTUAR], i lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, e sistemuar në vendin e punës sipas kontratës si Mjeke e Përgjithshme pranë Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Mamushë, i përfundon marrëdhënia e punës në Shërbimin Publik me datën 08.08.2025, në bazë të dorëheqjes së saj të paraqitur me vullnet të lirë.

Neni II

Obligohet Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale që, nga data 08.08.2025, ta largojë të lartpërmendurën nga lista e pagave, si dhe të ndër marrë veprimet përkatëse administrative në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni III

Ky vendim hyn në fuqi më datë 08.08.2025 dhe nga ai moment krijon pasoja juridike për palët e përfshira, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

A R S Y E T I M

znj. Xhenana Hyseni, me numër personal [REDAKTUAR], nga Komuna e Prizrenit, ka ushtruar detyrën e Mjekes së Përgjithshme pranë Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Mamushë, në përputhje me kontratën individuale të punës dhe detyrat e përcaktuara, deri më datën 08.08.2025, kur edhe i ndërpritet marrëdhënia e punës në Shërbimin Publik, në bazë të dorëheqjes së paraqitur me vullnet të lirë.

znj. Xhenana Hyseni, në cilësinë e nëpunëses publike, përmes një emali të dërguar më datë 08.08.2025, i është drejtuar U.D. Drejtorit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Mamushë, duke paraqitur deklaratën për dorëheqje, e cila është protokolluar me nr. 08.Nr.17-25 e datës 08.08.2025 Me këtë deklaratë, ajo ka njoftuar për ndërprerjen e marrëdhënies së saj të punës në Shërbimin Publik, në pozitën Mjeke e Përgjithshme pranë QKMF-së në Mamushë, me

arsyetimin se vendimi është marrë për arsye personale dhe profesionale, në përputhje me të drejtën ligjore për të ndërprerë marrëdhënien e punës me vullnet të lirë.

Marrëdhënia e punës i ndërpritet duke filluar nga data 08.08.2025, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe me vullnetin e lirë të nëpunësit publik.

Andaj, pas administrimit të provave dhe fakteve lidhur me gjendjen faktike, si dhe duke u bazuar në arsyetimet e paraqitura në letrën e dorëheqjes të znj. Xhenana Hyseni, në cilësinë e Mjekes së Përgjithshme pranë Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Mamushë.

Me marrëveshje të ndërsjellë ndërmjet punëdhënësit dhe punëmarrëses, është shmangur afati i njoftimit paraprak prej 30 (tridhjetë) ditësh, i parashikuar në legjislacionin në fuqi, me qëllim që ndërprerja e marrëdhënies së punës të bëhet në një afat më të shkurtër, për arsye personale të punëmarrëses, të cilat lidhen me rrethana që kërkojnë largimin e saj të menjëhershëm nga detyra.

Ky veprim është realizuar duke respektuar parimet ligjore dhe procedurat administrative të vlefshme për rastet e tilla.

Dorëheqja nga Shërbimi Publik është pranuar dhe është vendosur sipas dispozitivit të këtij vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi pala ka të drejtë ankese brenda afatit prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit, pranë Komisionit Komunal për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave.

Të njoftohen :
znj. Xhenana Hyseni
DSHMS
Zyra e Personelit
Arkivi

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdullah Krasnić





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti Republika Kosova-Republic of Kosovo Mamuşa Belediyesi-Komuna e Mamushës Opština Mamuša-Municipality of Mamusa	
Çikis - Dalëse - Izlaza - Outgoing	No.Nr. 160-25
Tarih/Dt.	02.08.2025

ZYRA E KRYETARIT

02 Nr. 160/25

Më:07.08.2025

Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushës, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

V E N D I M

Pagesë për përfaqësimin brenda vendit

Neni 1

Për mysafirët nga Republika e Turqisë për nder të Festivalit të XVI ndërkombëtar të domates në Komunën e Mamushës. Pagesë për përfaqësimin brenda vendit tek Operatori Ekonomik Furra Hasi-B me nr. të faturës 0003312 i datës 25.07.2025 në shumën e përgjithshme prej 129.60 euro.

Neni 2

Mjetet që lejohen për pagesë nga kategoria mallra dhe shërbime- sipas nr. zotimit 2025-153771.

Përfituesi	Nr. Unik	Xhirrollogaria	Shuma €
Bekom Collaku B.I	810993966	1705001012207818	129.60

Neni 3

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

ARSYETIM

Me datën 23.07.2025 në Komunën e Mamushës është organizuar Festivali i XVI të Domates, ku në këtë festival morën pjesë shumë mysafir nga Qeveria, Ministrinë, Komunitet tjerë si dhe Europa, Ballkani si dhe nga Republika e Turqisë.

Me këtë vendim të njoftohet

1. Drejtorisë Përkatese;
2. Palëve;
3. Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Mamuşa Belediyesi-Komuna e Mamushës
Opština Mamuša-Municipality of Mamusa

Çikis - Dalëse - Izlazna - Outgoing

02 No.Nr. 139-25

Tarih/Dt. 07.08.2025

ZYRA E KRYETARIT

02 Nr. 139 /25

Më:07.08.2025

Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushës, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

V E N D I M

Pagesë për përfaqësimin brenda vendit

Neni 1

Për mysafirët nga Republika e Turqisë për nder të Festivalit të XVI ndërkombëtar të domates në Komunën e Mamushës. Pagesë për përfaqësimin brenda vendit tek Operatori Ekonomik Ersan R.Morina B.I me nr. të faturës 25-SHV01-001-10 i datës 25.07.2025 në shumën e përgjithshme prej 129.60 euro.

Neni 2

Mjetet që lejohen për pagesë nga kategoria mallra dhe shërbime- sipas nr. zotimit 2025-153776.

Përfituesi	Nr. Unik	Xhirrollogaria	Shuma €
Ersan R.Morina B.I	812001246	2012-0002220496-74	856.00

Neni 3

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

ARSYETIM

Me datën 23.07.2025 në Komunën e Mamushës është organizuar Festivali i XVI të Domates, ku në këtë festival morën pjesë shumë mysafir nga Qeveria, Ministrinë, Komunitet tjerë si dhe Europa, Ballkani si dhe nga Republika e Turqisë.

Me këtë vendim të njoftohet

1. Drejtorisë Përkatesë;
2. Palëve;
3. Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës


Abdullah Krasniq





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



ZYRA E KRYETARIT

02 Nr. 138/25

Më: 07.08.2025

Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushës, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

V E N D I M

Pagesë për përfaqësimin brenda vendit

Neni 1

Për mysafirët nga Republika e Turqisë për nder të Festivalit të XVI ndërkombëtar të domates në Komunën e Mamushës. Pagesë për përfaqësimin brenda vendit tek Operatori Ekonomik Mifabeli SHPK me nr. të faturës 25-SHV01-005-104 i datës 29.07.2025 në shumën e përgjithshme prej 2,300.00euro.

Neni 2

Mjetet që lejohen për pagesë nga kategoria mallra dhe shërbime- sipas nr. zotimit 2025-153764.

Përfituesi	Nr. Unik	Xhirrollogaria	Shuma €
Mifabeli SHPK	811287821	2028000166874789	2,300.00

Neni 3

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

ARSYETIM

Me datën 23.07.2025 në Komunën e Mamushës është organizuar Festivali i XVI të Domates, ku në këtë festival morën pjesë shumë mysafir nga Qeveria, Ministritë, Komunitet tjerë si dhe Europa, Ballkani si dhe nga Republika e Turqisë.

Me këtë vendim të njoftohet

1. Drejtorisë Përkatesë;
2. Palëve;
3. Arkiva





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti Republika Kosova-Republic of Kosovo Mamuša Belediyesi-Komuna e Mamushës Opština Mamuša-Municipality of Mamusa	
Çıkış - Dalëse - Izlazna - Outgoing	
No.Nr.	137-25
Tarih/Dt.	07.08.2025

ZYRA E KRYETARIT

02 Nr. 137-25
Më:07.08.2025
Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushës, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

V E N D I M

Pagesë për përfaqësimin brenda vendit

Neni 1

Për mysafirët nga Republika e Turqisë për nder të Festivalit të XVI ndërkombëtar të domates në Komunën e Mamushës. Pagesë për përfaqësimin brenda vendit tek Operatori Ekonomik Agroturizëm Foleja Zanave SHPK me nr. të faturës 2025-07-SHV003 i datës 30.07.2025 në shumën e përgjithshme prej 251.60euro.

Neni 2

Mjetet që lejohen për pagesë nga kategoria mallra dhe shërbime- sipas nr. zotimit 2025-153784.

Përfituesi	Nr. Unik	Xhirrollogaria	Shuma €
Agroturizëm Foleja Zanave SHPK	812122498	1301001003925885	251.60

Neni 3

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

ARSYETIM

Me datën 23.07.2025 në Komunën e Mamushës është organizuar Festivali i XVI të Domates, ku në këtë festival morën pjesë shumë mysafir nga Qeveria, Ministrinë, Komunitet të tjera si dhe Europa, Ballkani si dhe nga Republika e Turqisë.

Me këtë vendim të njoftohet

1. Drejtorisë Përkatesë;
2. Palëve;
3. Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Beledijesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti Republika Kosova-Republic of Kosovo Mamuša Beledijesi-Komuna e Mamushës Opština Mamuša-Municipality of Mamusa	
Çikish - Dalëse - Izlazna - Outgoing	No.Nr. 136-25
Tarih/Dt. 02.08.2025	

ZYRA E KRYETARIT

02 Nr. 136/25

Më:07.08.2025

Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushës, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

V E N D I M

Pagesë për përfaqësimin brenda vendit

Neni 1

Për mysafirët nga Republika e Turqisë për nder të Festivalit të XVI ndërkombëtar të domates në Komunën e Mamushës. Pagesë për përfaqësimin brenda vendit tek Operatori Ekonomik Agroturizëm Foleja Zanave SHPK me nr. të faturës 2025-07-SHV003 i datës 31.07.2025 në shumën e përgjithshme prej 255.00euro.

Neni 2

Mjetet që lejohen për pagesë nga kategoria mallra dhe shërbime- sipas nr. zotimit 2025-153788.

Përfituesi	Nr. Unik	Xhirrollogaria	Shuma €
Agroturizëm Foleja Zanave SHPK	812122498	1301001003925885	255.00

Neni 3

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

ARSYETIM

Me datën 23.07.2025 në Komunën e Mamushës është organizuar Festivali i XVI të Domates, ku në këtë festival morën pjesë shumë mysafir nga Qeveria, Ministrinë, Komunat e tjera si dhe Europa, Ballkani si dhe nga Republika e Turqisë.

Me këtë vendim të njoftohet

1. Drejtorisë Përkatesë;
2. Palëve;
3. Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality of Mamushë

02 Nr. 135 / 2025
Datë : 05.08.2025



Duke u bazuar në Ligji nr. 08/L-197 Për Zyrtarët Publik, , lidhur me nenet 21, 22, neni 46, 47, 48 lidhur me nenin të ligji nr. 05/L -031 për procedurën e përgjithshme administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 20 / 21 qershor 2016, Prishtinë).

V E N D I M

Refuzohet: Kërkesa e Suna Morina, Hayrulla Mazrek, Sibel Taç, Resit Mazrek, Kubra Taç, Sihana Uka, Visar Sala, Yuksen Topoyani, Shefkije Morina, Skender Sala, Emrah Morina, Seylan Alaybeg, Esra Osi, Nazmi Morina, Gëzime Ibrahim, Nusret Morina, Fahri Kruezi, Fetah Morina, Labinot Muhaxheri, Mehmet Morina, Gazmend Gashi, Engin Taç, Erhan Tac, Ajet Sadiki, Besire Gjini, Çabej Nurkollar, Erdinç Morina, Aziz Elshani, Idriz Mazrek, Gafur Mazrek, Gulan Kruezi, Esat Morina, Afrim Mazreku, Alban Sadiki, Elez Taç, me numër të protokollit 02.Nr.48/25 e datës 04.08.2025 të parashtruar në Zyren e Zyrtarit Kryesor Administrativ Mamushë me të cilin kërkon që të merret Vendim me të cilin aprovohet kërkesa si e bazuar dhe të bëhet Kompensimi e dëmit për mjetet e munguara nga Lista Pagave SH.C.K, shtesën të cilët punëtorët e kanë gëzuar vite më herët, shtesë e cila është ndërprerë nga hyrja në fuqi e Ligjit të Pagave në shkurt të vitit 2023 dhe kompensimin e vlerës sipas përvojës së punës nga 0,25% tani e tutje në 0,50% kur ka hyrë Ligji i Pagave në Fuqi e në vazhdimësi. *Si e pa bazuar.*

A R S Y E T I M

Kërkesa për kompensimin e dëmit lidhur me përvojën e punës për punëtorët e SH.C.K, e cila është ndërprerë me hyrjen në fuqi të Ligjit për Pagat në Sektorin Publik në shkurt të vitit 2023, si dhe kërkesa për kompensim të përvojës së punës nga 0.25% në 0.5%, vlerësohet si e pabazuar në legjislacionin aktual.

Gjykata Kushtetuese me Aktgjykimin nr. ref. AGJ 2316/24, të datës 23.04.2024, ka shpallur të pavlefshëm nenin 45, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i cili përjashtonte nga kompensimi përfitime të ndryshme përveç atyre të përcaktuara me ligj dhe rregullore. Megjithatë, ky aktgjykim nuk e obligon Komunën që të realizojë menjëherë kompensimin e përvojës së punës në pagë, por kërkon nga Qeveria e Republikës së Kosovës që brenda 6 muajve të ndërmarrë veprimet përkatëse për plotësim-ndryshim të ligjit dhe ta dërgojë në Kuvend për shqyrtim e miratim.

Derisa nuk është bërë ndryshimi i ligjit dhe nuk ka bazë të re ligjore të miratuar nga Kuvendi, pagesë për përvojën e punës bëhet në atë mënyrë që lejohet dhe atë në masën zero pikë njëzetë e pesë për qind (0.25%) për çdo vit të plotë pune deri në pesëmbëdhjetë vite (15) punë dhe zero pikë pesë për qind (0.5%) për çdo vit të plotë pune mbi pesëmbëdhjetë vite (15) punë.

Për më tepër, Ligji Nr. 08/L-332 për ndarjet buxhetore për vitin 2025, në nenin 34, kërkon që zotimi i mjeteve për pagesat e pagave dhe përfitimeve të tjera të bëhet vetëm për ato kategori të kompensimeve të cilat janë të përcaktuara në legjislacionin në fuqi dhe të miratuara deri në fund të muajit janar. Përvojat e punës në masën e pretenduar nuk janë përfshirë në ndonjë dispozitë ligjore ose akt nënligjor aktual, për rrjedhojë nuk është bërë as zotimi i mjeteve për to, dhe çdo pagesë eventuale përbën shkelje të legjislacionit në fuqi.

Po ashtu, është me rëndësi të theksohet se ndryshimin e përfitimit të përvojës së punës nuk mund ta bën Komuna e Mamushës, por këtë duhet të bëhet me zbatimin nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, përkatësisht nga Thesari i Kosovës, që është organ përgjegjës për pagesat dhe zbatimin e Ligjit të Pagave.

Për këto arsye, dhe në mungesë të një baze të qartë ligjore për realizimin e kompensimit të përvojës së punës në masën 0.5%, si dhe në mungesë të Legjislacionit në fuqi, zotimit të mjeteve përkatëse për këtë qëllim, kërkesa refuzohet si e pabazuar dhe juridikisht e perealizueshme.


Këshillë Juridike: Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë ankesë në KPMSH në afat prej 30 ditësh.





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



02 Nr. 134/25
Me 06.08.2025
Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, Rregullore (QRK) nr.06/2023 për kompenzimin për udhëtime zyrtare dhe shpenzime të përfaqësimit dhe nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushës, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

AKTVENDIM

Regjistrimi furnitor për avans për udhëtime jashtë vendit

Neni 1

Përshkrimi: Avans për udhëtime jashtë vendit në Republikën e Turqisë 29.07.2025 deri më 02.08.2025.

Përfituesi	Pozita	ID	Xhirollogaria/ Banka
Yayha Sala	Drejtor i Administratës së Përgjithëshme	1232587080	2025000205866611-TEB

Neni 2

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë nga dita e nënshkrimit.

Me këtë vendim njoftohet:

- Drejtoria për Buxhet dhe Financa/ZKF
- Thesari-MFPT
- Arkiva





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti Republika Kosova-Republic of Kosovo Mamuşa Belediyesi-Komuna e Mamushës Opština Mamuša-Municipality of Mamusa	
Çıkış - Dalëse - Izlaza - Outgoing	No.Nr. 133-25
Tarih/Dt.	04.08.2025

ZYRA E KRYETARIT

02 Nr. 133/25

Më:04.08.2025

Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushës, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

V E N D I M

Pagesë për përfaqësimin brenda vendit

Neni 1

Për mysafirët nga Republika e Turqisë për nder të Festivalit të XVI ndërkombëtar të domates në Komunën e Mamushës. Pagesë për përfaqësimin brenda vendit tek Operatori Ekonomik Lika-A SHPK me nr. të faturës 03-2025 i datës 23.07.2025 në shumën e përgjithshme prej 2,500.00 euro.

Neni 2

Mjetet që lejohen për pagesë nga kategoria mallra dhe shërbime- sipas nr. zotimit 2025-152566.

Përfituesi	Nr. Unik	Xhirrollogaria	Shuma €
Lika A SHPK	810969876	1705001012003148	2,500.00

Neni 3

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

ARSYETIM

Me datën 23.07.2025 në Komunën e Mamushës është organizuar Festivali i XVI të Domates, ku në këtë festival morën pjesë shumë mysafir nga Qeveria, Ministritë, Komunitet të tjera si dhe Europa, Ballkani si dhe nga Republika e Turqisë.

Me këtë vendim të njoftohet

1. Drejtorisë Përkatesë;
2. Palëve;
3. Arkiva

